



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Dorezuar Primi/Prilidat Received/Delivery | 18.10.2022 | viti god. year. | 2 |
| Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKRMBHCK | 6294 | 2022 | 113 |



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.777/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.777/2022 të datës 07.09.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

në Komunën e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike-administrative "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 18.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.777/2022 të datës 07.09.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datën 07.09.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me shpalljen e konkursit të datës 03.06.2022 për pozitën Drejtor të Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me pretendimet ankimore kundër Vendimit Nr.3795/2022 të datës 26.08.2022, i nxjerrë nga Komisioni i Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik pranë kësaj ministrie.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 07.09.2022 me Nr.protokolli 5200/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.3795/2022 të datës 26.08.2022 nga Komisioni i Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik; Njoftimin me numër Nr.3440/2022 te



datës 05.08.2022 nga Divizioni i burimeve njerëzore në MKRS; Njoftimin e datës 05.08.2022 përmes e-mailit zyrtar; Prokurën për përfaqësim ligjor të datës 06.09.2022 nga përfaqësuesi me autorizim i ankuesit; Testin me shkrim të datës 28.07.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 15.09.2022 nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar të kandidatëve të datës 03.07.2022; Listën e kandidatëve të ftuar për testin me shkrim; Testet me shkrim të datës 28.07.2022; Listën e ngushtë për intervistën me gojë; Formularët e vlerësimit individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08A; Njoftimin me numër Nr.3440/2022 të datës 05.09.2022 për kandidatin e suksesshëm; Ankesën e ankuesit me numër Nr.3676/2022 të datës 19.08.2022 e parashtruar tek Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave në MKRS; Prokurën për përfaqësim ligjor të datës 18.08.2022 nga përfaqësuesi me autorizim i ankuesit Njoftimin me numër Nr.4078/2022 të datës 12.09.2022 lidhur me anulimin e konkursit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, është konstatuar se ankuesi ka aplikuar në konkursin e datës 03.06.2022, të shpallur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për pozitën Drejtor të Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota". I njëjti me datën 07.09.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore me pretendimet ankimore kundër Vendimit Nr.3795/2022 të datës 26.08.2022, i nxjerrë nga Komisioni i Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik pranë kësaj ministrie. I pakënaqur me rezultatin për shpalljen e kandidatit të suksesshëm i njëjti me datën 19.08.2022, ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik, ndërsa ky i fundit me Vendimin me Nr.3795/2022 të datës 26.08.2022 e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ndërlidhur me kompetencën lëndore të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për të vendosur për këtë çështje, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 2 paragrafit 4, ku përcaktohet se: "*Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtëpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike*" dhe si rrjedhojë ka konstatuar se pozita Drejtor i Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" i shpallur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për të cilën ka aplikuar ankuesi hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit publik, rrjedhimisht pozita në fjalë nuk është pozitë e shërbimit civil. Andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet që Këshilli është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës



për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi.

Bazuar në dispozitat e nenit 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe duke marrë parasysh se ankuesi ka shfrytëzuar mjetet ankimore brenda institucionit, Kolegji i Këshillit e udhëzon palën ankuese për inicimin e kontestit të punës në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.777/2022, datë 18.10.2022.

Ardita Perçuku-SHYTI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.